



A.nr.668/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, më Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.668/2026, të datës 19.06.2026, të parashtruar nga ankuesi B.H, nga Prishtina, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Agron Kajtazi, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 20.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.668/2026, e datës 19.06.2026, e parashtruar nga ankuesi B.H.

II. Mbetet në fuqi akti/përgjigjja me numër të protokollit nr.910, të datës 26.05.2026, të Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Ankuesi, B.H (*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 19.06.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Përgjigjes me numër të protokollit nr.910, të datës 26.05.2026, të Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme ndaj Kërkesës për njohjen dhe pagesën e përvojës së punës nga 0.25% në 0.5%, dhe kompensimin retroaktiv nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr.08/L-196 e deri me datën 31 dhjetor 2025.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 2767/2026 të datës 19.06.2026, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Kërkesë për njohjen dhe pagesën e përvojës së punës me numër të protokollit 906 e datës 08.05.2026; Përgjigjen me numër të protokollit nr.910, të datës 26.05.2026 të Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Autorizimin e datës 27.04.2026; Përgjigjjen në kërkesë e datës 03.07.2026; Akt emërimit të ankuesit të datës 08.06.2020; Listën e pagave.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankuesve është e pabazuar, sepse:

I. Gjendja e çështjes

Nga shqyrtimi i provave të administruara rezulton se:

- Ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 08.06.2020, është i punësuar në pozitën *Administrator i Lartë i IT-së për Baza të të Dhënave*, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.
- Ankuesi më datë 08.05.2026 i është drejtuar më kërkesë Ministrisë së Punëve të Brendshme, për njohjen dhe pagesën e përvojës së punës nga 0.25% në 0.5%, dhe kompensimin retroaktiv nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr.08/L-196 e deri me datën 31 dhjetor 2025.
- Më datë 26.05.2026, Udhëheqësi i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme ka refuzuar Kërkesën e ankuesit të datës 08.05.2026, për njohjen dhe pagesën e përvojës së punës nga 0.25% në 0.5%, dhe kompensimin retroaktiv nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr.08/L-196 e deri me datën 31 dhjetor 2025.

II. Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon se më datë 08.05.2026, i është drejtuar punëdhënësit, Ministrisë së Punëve të Brendshme, me kërkesë zyrtare për realizimin për njohjen dhe pagesën e përvojës së punës nga 0.25% në 0.5%, dhe kompensimin retroaktiv nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr.08/L-196 e deri me datën 31 dhjetor 2025, mirëpo, Ministria e Punëve të Brendshme ka refuzuar kërkesën me arsyetim se në mungesë të një vendimi të veçantë që autorizon kompensim retroaktiv për periudhën e kërkuar, Ministria e Punëve të Brendshme nuk ka bazë ligjore dhe buxhetore për të proceduar pagesa të tilla përtej periudhës së përcaktuar nga autoritetet kompetente. Kërkon që të aprovohet ankesa, të anulohet përgjigjja me numër të protokollit nr.910, të datës 26.05.2026 të Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme më të cilën është refuzuar kërkesa e ankuesit si dhe kërkon që t'i njihet e drejta e përvojës së punës në masën 0.5% për çdo vit pune, që nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr.08/L-196, me datë 06.02.2023 e deri me datën 31 dhjetor 2025, si dhe t'i bëjë pagesën retroaktive të diferencës në pagë, për çdo muaj ku është aplikuar padrejtësisht shtesa në nivelin 0.25% duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196, me datë 06.02.2023 e deri me datën 31 dhjetor 2025.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Lidhur me pretendimin e ankuesit referuar kompensimit lidhur më përvojën e punës, Kolegji i Këshillit iu referua nenit 6 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, me të cilin është përcaktuar se: *“6. Paga bazë rritet në bazë të përvojës së punës, në masën: 6.1. zero pikë njëzetë e pesë për qind (0.25%) për çdo vit të plotë pune, deri në pesëmbëdhjetë vite (15) punë; dhe 6.2. zero pikë pesë për qind (0.5%) për çdo vit të plotë pune, mbi pesëmbëdhjetë vite (15) punë”*, dispozita këto të cilat i janë nënshtruar vlerësimit të kushtetutshmërisë nga ana e Gjykatës Kushtetuese, më ç’rast, kjo e fundit, me Aktgjykimin për rastin nr. KO79/23, ref.: Nr.Ref. 2682, në pikën II të dispozitivit ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 [Mbrotja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrotja e pronës) të Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ndërsa, në pjesën arsyetues gjegjësisht në pikët 380 dhe 381 ka sqaruar: 380. *Gjykata ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) dhe paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 (Shtesa*

tranzitore) të Ligjit të kontestuar janë në kundërshtim me Kushtetutën, përkatësisht me të drejtën në gëzimin paqësor të pronës dhe barazinë para ligjit. Kjo, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, ndër të tjera, sepse (i) zbritja joproporcionale e nivelit të pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Kosovës është në kundërshtim të plotë me parimet kushtetuese, ligjore, parimet relevante ndërkombëtare dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe përtej cenimit të të drejtave respektive individuale, rezulton edhe në cenim të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe vlerave të Republikës së Kosovës;...ndërsa (v) përgjysmimi i shtesës për përvojën e punës për të gjithë kategorinë e funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve për pesëmbëdhjetë (15) vitet e para të përvojës së punës, kufizon të drejtat dhe liritë themelore të tyre, pa asnjë qëllim legjitim në kundërshtim me përcaktimet e nenit 55 të Kushtetutës. 381. Thënë këtë, sipas sqarimeve të dhëna më sipër ndërlidhur dhe me efektin e Aktgjykimeve të Gjykatës, kjo e fundit (i) nuk do të shfuqizojë paragrafin 6 të nenit 6 (Paga bazë) të Ligjit të kontestuar, ndërsa (ii) do të shfuqizojë paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar. 382 Kjo sepse, lidhur me paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar që ndërlidhet me shtesën mbi pagën për përvojën e punës, Ligji i kontestuar në paragrafin 1 të nenit 45 të tij, ka shfuqizuar edhe Ligjin nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, i cili përfshin nenin 18 (Shtesa mbi pagën për përvojën e punës) sipas të cilit, për çdo vit të përvojës së punës të kaluar në shërbimin civil dhe jashtë tij, përveç përvojës së kaluar në punë praktike, nëpunësit civil sipas këtij ligji i takon e drejta shtesë në pagën bazë prej zero pikë pesë përqind (0,5%). Shpallja e pavlefshme e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar i kombinuar me faktin që Ligji nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë shfuqizohet gjithashtu përmes paragrafit 1 të nenit 45 të Ligjit të kontestuar, do të rezultonte në zbrazëti ligjore, përkitazi më të drejtën për shtesa mbi pagën për përvojën e punës. Për pasojë, duke balancuar parimin e sigurisë juridike dhe të drejtat dhe liritë themelore, **Gjykata do të lë në fuqi paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në periudhën prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi, duke i përcaktuar detyrimin Kuvendit, që brenda kësaj periudhe të ndryshojë dhe/ose plotësojë paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në pajtim me konstatimet e këtij Aktgjykimi.** Në ndryshimin dhe/ose plotësimin e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar, Kuvendi duhet të ketë parasysh që efektet e ndryshimit/plotësimit të tij në kontekst të lartësisë së shtesës për përvojën e punës burojnë që nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi”.

Andaj, duke qenë së Kuvendi i Kosovës brenda afatit të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese nuk ka bërë plotësim/ndryshimin e paragrafi 6 të nenit 6 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Këshilli në mungesë të këtij rregullimi ligjor, nuk ka juridiksion ligjor që të detyroj institucionet publike të bëjnë kompensimin e përvojës së punës për zyrtarët publikë sipas aktgjykimit kushtetues dhe rrjedhimisht mbi këtë bazë pretendimi ankimor mbi rrethanat ekzistuese nuk ka mbështetje ligjore.

Thënë më tepër, e bazuar në përcaktimet kushtetuese sipas Aktgjykimit në rastin nr. KO79/23, Këshilli tashme ka qëndrim të konsoliduar që rregullat dhe kushtet lidhur më pagat dhe kompensimet tjera të të punësuarve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i ligjit për pagat në sektorin publik dhe se efektet e Aktgjykimit në rastin nr. KO79/23, referuar paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik do të rrjedhin nga data e publikim të këtij aktgjykimin (pra nga data 28.04.2024).

Theksuar si më sipër, Kolegji bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, vendosi si në dispozitivit të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.668/2026

Merlinda RAMAJ

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të Autorizuar Avokat Agron Kajtazi;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në MPB; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.